



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201112/27

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandim për nisjen e procedurës për dhënien e shpërblimit stafit mbështetës dhe shëndetësor të IEVP-ve, në zbatim të VKM Nr.207, datë 10.03.2020 "Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë".*

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Tiranë

E nderuar Znj. Koçiu,

Institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë në shqyrim disa ankesa të personelit shëndetësor të Qendrës Spitalore të Burgjeve lidhur me trajtimin e tyre financiar.

Një nga këto ankesa ka të bëjë me mos marrjen e një shpërblimi për punën e kryer gjatë periudhës kur në Qendrën Spitalore të Burgjeve funksiononin 2 pavione për pacientë të infektuar me virusin Covid-19.

Për verifikimin e kësaj ankese jemi interesuar më parë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila na ka vënë në dijeni për sa vijon: Me VKM Nr.207, datë 10.03.2020 "Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë", është caktuar dhënia e shpërblimit financiar **për personelin mjekësor dhe mbështetës** të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-

19. Kjo VKM ngarkon për zbatimin e saj Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Fondi për dhënien e shpërblimit do të përballohej nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2020. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i ka dërguar institucionit tuaj dhe Ministrisë së Drejtësisë listën emërore të personelit shëndetësor dhe mbështetës që kanë trajtuar të burgosur të prekur nga virusi Covid-19, duke kërkuar nisjen e procedurës për marrjen e shpërblimit të përcaktuar në VKM Nr. Nr.207, datë 10.03.2020. Institucioni juaj nuk ka pranuar kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke u shprehur se ka në kompetencë miratimin e trajtimit financiar vetëm për stafin mjekësor të institucioneve në varësi të saj¹. Në vijim, Ministria e Drejtësisë ju është drejtuar me shkresën Nr. 1600/3 Prot., datë 22.04.2021, ku kërkon rishikimin e qëndrimit tuaj, duke dhënë argumente sipas interpretimit që i ka bërë VKM Nr.207, datë 10.03.2020. Këto argumente janë si më poshtë vijon:

1. VKM-ja Nr. 207, datë 10.08.2020 *“Për dhënie shpërblimi për personelin mjekë, infermier dhe të tjerë”*, në asnjë pikë të saj nuk bën një dallim midis stafeve mjekësore mbi bazën e cilit institucion epror janë në varësi.
2. VKM-ja trajton shpërblimin e stafeve mjekësore duke evidentuar vetëm një cilësi të tyre dhe që është fakti se këto stafe janë angazhuar, në këtë situatë të pandemisë me diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.
3. Ky akt nënligjor përcakton në pikën 1 dhe 2 të tij si më poshtë:
“1. Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, për personelin mjekësor, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.
2. Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë), lekë, për personelin mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”,

¹ Shkresa Nr. 3807/2 Prot., datë 03.09.2020.

duke mos bërë një saktësim apo diferencim të varësisë së këtij personeli.

4. Për më tepër që kjo VKM parashikon trajtimin financiar edhe për ish profesionistë të shëndetësisë, që nuk janë më në marrëdhënie pune në sistem, jo më në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
5. Një argument tjetër në favor të interpretimit është dhe parashikimi i pikës 5 të VKM-së, dhe citojmë: *“Fondi për shpërblimin e personelit, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë, sipas pikave 1,2 e 3, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2020”*, pra këto fonde do të jenë të buxhetit të shtetit dhe jo prej atyre të miratuara, vetëm për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
6. Më tej vlerësohet se VKM-ja e sipërcituar ka ngarkuar me detyra Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Konkretisht në pikën 6 të saj dhe citojmë: *“Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi”*. Pra, kjo ministri ngarkohet me miratimin çdo muaj me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të VKM-së, që përbën dhe arsyen përse nga ana e DPB-së Ju është përcjellë ky informacion, listë emërore etj.

Por, edhe pas këtij komunikimi shkresor, institucioni juaj ka mbajtur sërish të njëjtin qëndrim me shkresën Nr. 2003 Prot. datë 03.06.2021.

Bashkëlidhur këtij rekomandimi do të gjeni fotokopje të letërkëmbimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Duke analizuar ankesën e personelit shëndetësor të Qendrës Spitalore të Burgjeve, dokumentacionin e administruar në lidhje me korrespondencën midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së

Shëndetësisë dhe Mbrojtes Sociale si dhe kuadrit ligjor përkatës në fuqi, çmojmë se argumentet e dhënë nga Ministria e Drejtësisë për të shpërblyer personelin shëndetësor të IEVP-ve përkatëse, janë të qenësishme dhe në përputhje me frymën dhe interpretimin e VKM Nr. 207, datë 10.03.2020. Po ashtu, këto argumente janë në një linjë edhe me qëllimin e Kryeministrit për të vlerësuar përkushtimin e asaj pjese të administratës, të cilët mbajtën barrën kryesore në përballimin e situatës së paprecedentë të krijuar nga përhapja e Virusit Covid-19. VKM Nr.207, datë 10.03.2020, nuk bën asnjë dallim ndërmjet personelit në varësi të institucionit tuaj apo institucioneve të tjerë. Shpërblimi lidhet me faktin e angazhimit të pandërprerë të personelit, me një vështirësi e rrezik të shtuar të punës, në trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, përpjekje për të cilat duhet t'u jemi mirënjohës dhe falenderues.

Gjithashtu, vlen të sillen në vëmendjen tuaj një shqetësim i vazhdueshëm i ngritur nga ana jonë, që lidhet me organikën e paplotësuar të stafit shëndetësor në IEVP-të e vendit, për shkak të largimeve të mjekëve/infermierëve dhe vështirësisë për të gjetur zëvendësues, pavarësisht përpjekjeve për të rritur trajtimin financiar të tyre. Shkaqet e identifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për këtë mungesë interesi janë vështirësia e punës në burgje, izolimi nga bota e jashtme dhe trajtimi i pabarabartë i personelit mjekësor, në krahasim me atë të kolegëve që punojnë në spitalet publike.

Qëndrimi juaj refuzues në këtë rast, do të ndikonte më tej në krijimin e një klime demotivuese, aspak stimuluese dhe vlerësuese për personelin mjekësor, për të punuar në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të vendit tonë, ku nga ana tjetër kontributi i tyre është i domodoshëm dhe jetik për të garantuar të drejtën për trajtim shëndetësor të të burgosurve.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e*

Popullit" i ndryshuar ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive".

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëhershme për nisjen e procedurës për dhënien e shpërblimit stafit mbështetës dhe shëndetësor të IEVP-ve, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19, në zbatim të VKM Nr.207, datë 10.03.2020 "*Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë*".

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca